



Academy of Technology  
and Digital Design

# SOFTWARE DEVELOPER - PROGRAMER

Program Profesional

2 Semestra (12 muaj)

E akredituar dhe licensuar nga:





Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

# ZHVILLUES SOFTUERI PROGRAMER

Qëllimi i këtij programi të avancuar njëvjeçar është të trajnojë, dhe certifikojë pjesëmarrësit si Zhvillues Softueri/Programer, duke dëshmuar njohuritë dhe shkathtësitë e tyre profesionale në teknologjitë moderne.

Me fitimin e kualifikimit “Software Developer - Programer/e”, kandidatët përvetësojnë njohuri të thella nga kurrikula jonë moderne, duke përfshirë Front-End dhe Back-End. Studentët kanë një kuptim të mirë të kodimit dhe programimit, duke u përgatitur për të punuar në industrinë e teknologjisë digjitale për web, mobile, games, inteligjencë artificiaiale, big-data apo për zgjidhjen e problemeve teknike. Programimi dhe edukimi teknik janë thelbësorë për ata që duan të zhvillojnë dhe mirëmbajnë zgjidhje softuerike të bazuara në server, një fushë që po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Si rezultat, zhvilluesit softuerikë janë ndër profesionistët më të kërkuar në industrinë e teknologjisë.





Kohëzgjatja e programit:

**12 muaj**

Kreditë e fituara gjatë programit:

**60 kredi**

## REZULTATET E PRITURA

- Zhvillimi i aplikacioneve duke përdorur gjuhët programuese Java, JavaScript, C#, React/Native, si dhe HTML/CSS
- Dizajnimi dhe strukturimi efikas i bazave të të dhënave.
- Integrimi i platformave të ndryshme softuerike.
- Zbatimi i praktikave të sigurisë gjatë zhvillimit të aplikacioneve.
- Testimi i aplikacioneve dhe zgjidhja e shpejtë e problemeve.
- Demonstrimi dhe administrimi i kodit burimor.
- Aplikimi i analizave dhe dizajnit sipas kërkesave të biznesit.

# PROGRAMI I LËNDËVE:

- Teknologji Informative
- Codim HTML, CSS, Javascript
- Programim
- Baza të të Dhënave
- Multimedia Teknologji
- Ndërveprimi Njeri-Kompjuter (HCI), UX/UI
- Zhvillimi i Aplikacioneve në Ueb
- Gjuhë dhe Teknologji Uebi
- Inxhinieri Softuerike
- Zhvillimi i Aplikacioneve Mobile
- Matematikë për Inxhinieri
- Zhvillimi i Aplikacioneve të Avancuara në Ueb
- Dizajni i Ndërfaqes Përdoruesit
- REST API
- Vendosja e serverit
- Aplikacione Mobile të Avancuara



# MUNDËSI PËR KARRIERE

- Zhvilluesi i Backend-it
  - Zhvilluesi i Frontend
  - Arkitekt i Sistemit
  - Inxhinier Softueri
  - Zhvilluesi i API
  - Konsulent IT
  - Programer
- Zhvilluesi i aplikacionit
  - Zhvilluesi i Ueb Faqeve
  - Cloud Architect
  - Projektuesi i ndërveprimit
  - Mobile App Programer



## REZULTATET E MËSIMIT

Ju do të filloni programin duke ndërtuar një bazë solide ku shpjegohen konceptet themelore të programimit. Ky themel do të përforcohet më tej përmes programimit të orientuar drejt objektit për të zhvilluar zgjidhje të strukturuar dhe të ripërdorshme. Për të siguruar një qasje holistike ndaj procesit të zhvillimit, janë prezantuar metodologjitë për planifikimin dhe menaxhimin e projektit. Përmes mësimit të thelluar të JavaScript në anën e serverit, administrimit të bazës së të dhënave dhe hartimit të API-ve RESTful, ju do të fitoni aftësi të tjera thelbësore.

Gjatë gjithë programit, ju do të keni detyra praktike që sigurojnë aftësinë tuaj për të kryer zhvillimin në praktikë me ndihmën e teorisë përkatëse. Si student i zhvillimit të backend-it, ju do të zhvilloni kompetencën tuaj përmes punës profesionale dhe metodologjive të softuerit që përdoren zakonisht nga zhvilluesit profesionistë të backend-it.

Ne edukojmë studentët tanë për të ofruar zgjidhje digjitale për çdo problem kompleks.



# PSE TË ZGJIDHNI PROGRAMIN TONË TË PROGRAMER?

Në një botë ku teknologjia dhe softueri janë në qendër të çdo aspekti të jetës moderne, të qenit zhvillues aplikacionesh është një mundësi e jashtëzakonshme karriere. Programi ynë i akredituar i Zhvillimit të Aplikacioneve ofron përgatitjen ideale për t'u bërë një profesionist i suksesshëm në këtë fushë dinamike.

Synojmë t'ju pajisim me aftësitë dhe njohuritë që ju nevojiten për të ndërtuar aplikacione inovative dhe të sigurta, duke iu përgjigjur kërkesave të ndryshme të biznesit dhe klientëve. Të diplomuarit tanë do të jenë të përgatitur për të punuar si zhvillues aplikacionesh, programerë, inxhinierë të softuerit, dhe shumë pozita të tjera në industrinë e teknologjisë.

Programi ynë është i akredituar dhe ofron një përgatitje të thelluar dhe praktike në zhvillimin e aplikacioneve. Nëse keni pasion për teknologjinë dhe dëshironi të zhvilloni zgjidhje softuerike që ndryshojnë botën, ne jemi këtu për t'ju ndihmuar të arrini suksesin tuaj profesional.



Academy of Technology  
and Digital Design

ATD Profesional Education Institution  
Lagjja Veternik, 10000  
Prishtinë, Kosovë  
+383 49 986 700

info@atd-academy.net  
www.atd-academy.net

Programet e akredituara:

Software Developer

Digital Design

Tregu i punës kërkon profesionistë, andaj bëhu zgjidhja e duhur për kompanitë vendore dhe ndërkombëtare, duke u regjistruar në ATD Academy në Prishtinë